

**THIRRJE
TERMAT E REFERENCËS**

Organizata	Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara - Handikos Ferizaj
Titulli	Ekspert/e apo Kompani
Lloji i konsulencës	Individuale ose Kompani
Lokacioni	Ferizaj, Kosovë
Kohëzgjatja	Prill, 2024 (10 ditë angazhim)
Data e fillimit (kur pritët)	Prill, 2024

Handikos Ferizaj

Handikos Ferizaj është organizatë jo-qeveritare e përkushtuar në rritjen e mirëqenies dhe pavarësimin e personave me aftësi të kufizuara, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe avokimit. Handikos Ferizaj punon për së afërmi me komunitetin, organizata të tjera si-motra, institucionet shëndetësore dhe autoritetet lokale e qendrore, për t'i shërbyer në mënyrë sa më efektive dhe të qëndrueshme përfituesve të saj.

Qëllimi i përgjithshëm i Konsulencës

Handikos Ferizaj, si organizatë që punon në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të personave me aftësi të kufizuara, angazhohet në ndërgjegjësimin e shoqërisë në fushën e të drejtave të rinjve/fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes muraleve, si pjesë e aktiviteteve tona në projektin **“Arti ynë tejkalon kufizimet”**. Ky projekt ka filluar fazën e implementimit që nga muaji Janar, 2024, dhe ka për qëllim fuqizimin e të rinjve/fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke dhënë mundësinë për ngritjen dhe zhvillimin e aftësive të tyre nëpërmjet artit dhe është financuar nga Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Për realizimin e këtij aktiviteti, ne si organizatë jemi në kërkim të një Eksperti/e apo Kompanie, i/e cila do të jetë përgjegjës/e për **realizimin e dy muraleve**, në hapësirat publike, në madhësi prej 100m² brenda qytetit të Ferizajt.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Planifikimi i ngjarjes;
- Koordinimi i artistëve;
- Menaxhimi i ekipit organizativ;
- Kontrolli i detyrave teknike dhe logjistike;
- Menaxhimi i emergjencave.

Kualifikimet dhe eksperiencia

- Diplomë Universitare në shkencat e artit, apo fushë të ngjashme (e preferuar) ;

- Përvojë paraprake në murale, apo në aktivitete të ngjashme artistike;
- Njohuri të çështjes së aftësisë së kufizuar në kontekstin vendor;
- Shkathtësi të larta hulumtuese në identifikimin e praktikave/modeleve të cilat përdoren në rajon dhe botë në këtë fushë;
- Shkathtësi ndër personale dhe të komunikimit;
- Ndjeshmëri ndaj kontekstit dhe situatave të ndryshme me qasje të hapur ndaj diversitetit.

Aplikuesit duhet të dorëzojnë

- Një draft propozim mbi metodologjinë e punës për këtë angazhim, përfshirë koston financiare të kalkuluar për ditët e angazhimit apo në total;
- Dy punime (mostër), të fushës përkatëse, të cilat demonstrojnë angazhimin tuaj;
- Një letër interesi që paraqet arsyet që ai/ajo është i/e përshtatshëm dhe ka njohuri dhe eksperiencë në fusha të ngjashme;
- Curriculum Vitae (CV);
- Dy referenca;
- Certifikatë Biznesi (për kompanitë).

Kohëzgjatja dhe pritjet

- Eksperti/e apo Kompania, do të angazhohet për një periudhë prej dhjetë (10) ditësh, gjatë periudhës **një mujore**.

Pagesa

Pagesa për Ekspert/e apo Kompani do të bëhet sipas përfundimit të përgjegjësive të kontraktura, varësisht nga ditët që është angazhuar. Duke u bazuar në ndjesinë e aktivitetit dhe në përfshirjen e koston së saj, pagesa ndahen në dy pjesë (50/50). Pagesa e parë bëhet para fillimit të punës dhe pjesa e dytë pas mbarimit të saj.

Procedurat e aplikimit

Aplikacionet duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike në e-mail adresën: handikosferizaj@gmail.com me subjektin *Aplikoj për "realizim të muraleve"*.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është **19.02.2024 ora 23:59h**.

Vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të kontaktohen. Gjatë gjithë procesit nuk ofrohen informata me telefon.